



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr 15254 prot.

Shkodër, me 18.7.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni .

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR ✓

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin “**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR**”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt!

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK, NË
TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54 shkronja “k”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të ndryshuar; VKM nr.408/2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; VKM nr.1096/2015 “Për miratimin e rregullave kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave Publike”; pas shqyrtimit të relacionit të administratës së bashkisë Shkodër;

VENDOSI :

1. Të miratojë rregulloren “Për Përcaktimin e Kriereve dhe Procedurave për Vendosjen e Veprave të Artit Publik, në Territorin e bashkisë Shkodër”, sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 pas shpalljes.

KRYETAR

Behet BECI

Z/Kryetar

Drejtorja e Kulturës

Sera Smajaj

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit
të Territorit

Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve Mbështetëse

Deja Jeshka H

Drejtorja Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROÇEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 54 shkronja “k”, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të ndryshuar; VKM nr.408/2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; VKM nr.1096/2015 “Për miratimin e rregullave kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave Publike”; paraqesim për shqyrtim projekt vendimin **“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROÇEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”**, si më poshtë:

I. Qëllimi i projekt-rregullores dhe objektivat që synohen të arrihen

Projekt-rregullorja “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik në territorin e Bashkisë Shkodër”, ka për qëllim të mundësojë legjitimitetin e vendosjes së busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, në hapësirat e juridiksionit të bashkisë Shkodër, me qëllim ruajtjen e kujtesës kombëtare, shprehjen e vlerave kulturore, historike dhe artistike që përfaqësojnë identitetin shpirtëror e material në rrafsh lokal, kombëtar dhe më gjërë.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje dhe procedurave që përcakton, synojmë të kemi një qasje sa më të drejtë, transparente dhe sistematike në lidhje me vendim-marrjen sa i përket:

1. Propozimeve për vendosje të veprave të artit publik në territorin e Bashkisë Shkodër;
2. Propozimeve për të riplanifikuar apo zhvendosur strukturat aktuale të veprave të artit publik;
3. Përfshin pjesëmarrjen e publikut apo grupeve të interesit në vendim-marrje.



Hartimin e kësaj rregulloreje e kemi gjykuar të nevojshëm për disa arsye kryesore;

4. Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore;

Rregullorja siguron ruajtjen sistematike të trashëgimisë kulturore duke vendosur udhëzime të qarta për vendosjen e strukturave memoriale dhe instalacioneve artistike.

Kjo ndihmon në ruajtjen e integritetit dhe rëndësisë historike të kujtesës kulturore lokale dhe kombëtare.

5. Qartësia ligjore dhe procedurale

Rregullorja, duke kodifikuar kriteret dhe procedurat për vendosjen e busteve, statujave, memorialeve dhe instalimeve artistike, jep qartësi ligjore. Kjo ndihmon në parandalimin e vendimeve arbitrare dhe siguron që të gjitha veprimet të jenë në përputhje me ligjet kombëtare dhe politikat lokale.

6. Promovimi i vlerave kulturore dhe historike

Rregullorja synon të promovojë vlerat kulturore, historike dhe artistike që përfaqësojnë identitetin shpirtëror dhe material të komunitetit local dhe më gjërë. Kjo kontribuon në një kuptim dhe vlerësim më të gjerë të trashëgimisë së rajonit dhe rolit të tij në kontekstin kombëtar.

7. Proçesi i strukturuar i vendimarrjes

Rregullorja prezanton një proçes të strukturuar për propozimin dhe miratimin e strukturave memoriale dhe instalimeve artistike. Ajo specifikon rolet dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme të interesit, duke siguruar që vendimet të merren në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

8. Angazhimi dhe gjithëpërfshirja e publikut

Duke lejuar propozime nga një gamë e gjerë palësh të interesuara – duke përfshirë kryetarin e bashkisë, anëtarët e këshillit, komunitetet fetare, organizatat jofitimprurëse dhe banorët – rregullorja promovon angazhimin dhe përfshirjen publike. Kjo siguron që komuniteti të ketë një zë në vendimet që prekin hapësirat e tyre publike.

9. Planifikimi Estetik dhe FunkSIONAL

Rregullorja siguron që vendosja e strukturave përkujtimore dhe e instalimeve artistike të përputhet me standardet urbanistike dhe estetike. Kjo ndihmon në ruajtjen e harmonisë vizuale dhe përdorimit funksional të hapësirave publike.



10. Zhvillimi i Qëndrueshëm

Duke u fokusuar në kushtet më të mira të përdorimit publik për pasuritë kulturore, rregullorja mbështet zhvillimin e qëndrueshëm kulturor. Kjo përfshin konsideratat për mirëmbajtjen dhe financimin afatgjatë, duke siguruar që memorialet dhe instalimet të mbeten në gjendje të mirë për brezat e ardhshëm.

11. Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik

Rritja e peisazhit kulturor të Shkodrës nëpërmjet vendosjes së rregulluar të artit dhe memorialeve mund të nxisë turizmin. Kjo, nga ana tjetër, kontribuon në zhvillimin ekonomik lokal duke tërhequr vizitorë dhe duke krijuar një komunitet më të gjallë.

12. Parandalimi i mosmarrëveshjeve dhe konflikteve

Kriteret dhe procedurat e qarta ndihmojnë në parandalimin e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve që mund të lindin nga vendosja arbitrare e strukturave përkujtimore dhe instalimeve artistike. Kjo siguron që të gjitha veprimet të jenë në përputhje me vlerat e komunitetit dhe kërkesat ligjore.

II. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projekt-rregullore.

Bashkia Shkodër ka ngritur grupin e punës “Për Hartimin e Rregullorës për Vendosjen e Busteve dhe Statujave në Territorin e Bashkisë Shkodër” me Urdhër nr.454 datë 02.04.2024.

Grupi i punës ka patur për detyrë hartimin e rregullores për vendosjen e busteve dhe statujave në territorin e bashkisë Shkodër. Grupi i punës gjatë hartimit të rregullores ka thirrë dhe marrë mendime nga personalitete të jashtme dhe grupe interesi.

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i kriterëve, proceduarave dhe autoriteteve përgjegjëse për vlerësimin, vendosjen, ruajtjen, mbrojtjen, administrimin e veprave të artit publik ; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art në hapësirat e juridiksionit të bashkisë Shkodër.

Parime të përgjithshme : Bashkia Shkodër në zbatim të kësaj rregulloreje është e angazhuar të mundësoj kushte, kriteret e vendosjes në mënyrë sa më të përshtatshme veprat e artit publik; buste; shtatore , memorial, instalacione artistike dhe Land-Art nëpër hapësirat publike në juridiksionin e saj.

Bashkia Shkodër në zbatim të kësaj rregulloreje është e angazhuar plotësisht të monitorojë, mbrojtë, hapësirat publike në juridiksionin e saj të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi referuar objektit të kësaj rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Shkodër ka prioritet në vizionin e saj, nxitjen e zhvillimit kulturor dhe turistik nën juridiksionin e saj, përmes vendosjes të veprave të artit publik, busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, përmes ruajtjes së kujtesës kombëtare, shprehjes së vlerave kulturore, historike dhe artistike që përfaqësojnë identitetin shpirtëror e material në rrafsh lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Sa më lart propozojmë para Këshillit Bashkiak të miratojë rregulloren **“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROÇEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet BECI



RREGULLORE

**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROÇEDURAVE PËR VENDOSJEN E
VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK NË
TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”**

Neni 1 **Baza ligjore**

- Kjo rregullore hartohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligjit 139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar;
- Ligjit 27/2018 “Për trashigimime kulturore dhe muzete”;

Neni 2 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është të mundësojë legjitimitetin e vendosjes së busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art (Vepra te Artit Publik) në hapësirat e juridiksionit të bashkisë Shkodër, me qëllim ruajtjen e kujtesës kombëtare, shprehjen e vlerave kulturore, historike dhe artistike që përfaqësojnë identitetin shpirtëror e material në rrafsh lokal, kombëtar dhe me gjërë.

Neni 3 **Objekti**

Objekt i kesaj rregullorje eshte percaktimi i kriterëve, procedurave dhe autoriteteve pergjegjese, per vleresimin, vendosjen, ruajten, mbrojtjen, administrimin e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art (Vepra te Artit Publik) në hapësirat e juridiksionit të bashkisë Shkodër.

Neni 4 **Parime të përgjithshme**

4.1 Bashkia Shkodër në zbatim të kësaj rregulloreje është e angazhuar të mundësojë kushte, procedurat dhe kriteret e vendosjes në mënyrë sa më të përshtatshme veprat e artit publik; buste, shtatore, memoriale, instalacione artistike dhe Land-Art nëpër hapësirat publike në juridiksionin e saj.

4.2 Bashkia Shkodër në zbatim të kësaj rregulloreje është e angazhuar plotësisht të monitorojë, mbrojë, hapësirat publike në juridiksionin e saj te percaktuara në dispozitat ligjore në fuqi referuar objektit të kësaj rregullore.

4.3 Bashkia Shkoder ka prioritet në vizionin e saj, nxitjen e zhvillimin kulturor dhe turistik nen juridiksionin e saj, përmes vendosjes të veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, përmes ruajtjes se kujtesës vendore dhe kombëtare, shprehjes se vlerave kulturore, historike dhe artistike që përfaqësojnë identitetin shpirtëror e material në rrafsh lokal, kombetar dhe me gjërë.

Neni 5
Përkufizimet
Veprave të artit publik

“**Bust**”, është një skulpturë e cila paraqet pjesën e sipërme të një personi, duke përfshirë pjesën e kokës, qafën, shpatulla dhe pjesë të gjoksit paraqitur në skulpture rrumbullake ose relief.

“**Shtatore**” është një skulpturë e lirë në të cilën paraqitet një figure e plotë.

“**Memoriali**” është një objekt ose vend autentik i kujteses i cili shërben si një fokus përkujtues, zakonisht për personalitete të shquara apo ngjarje me rëndësi që shtrihen në kohe dhe hapësirë. Ai paraqitet përmes:- Skulptura, Relievi, Busti, Shtatorja , Grup skulpturor, Ekuestri (figura në kale), Piktura Murale , Mozaiku mural dhe pavimental ,Vetrazhi, Skulptura e parkut, Lapidar, Skulptura Kinetike, vëllim i lirë tredimensional dhe Land-Art.

“**Instalacioni artistik**” përfshin , Skulptura Kinetike, skulpturen e lirë dhe assemblazhin e materialeve të ndryshme.

“**Land-Art**” nderthurje e artit me peisazhin dhe unifikimi i këtyre dy gjinive në elementin natyror artistiko-urban.

Neni 6
Vleresimi i vendosjes së veprave të artit publik

Vleresimi i vendosjes së veprave të artit publik, është ushtrimi i atyre funksioneve e aktiviteteve nga njesia veteqeverisjes vendore, që kanë si qëllim studimin, njohjen dhe promovimin e pasurisë kulturore, që sigurojnë kushtet me të mira të shfrytëzimit publik të pasurive e vlerave kulturore për një zhvillim të qëndrueshëm.

Neni 7
E drejta e propozimit

Propozimi për vendosjen/riplanifikimin e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, mund të bëhet nga :

- a) Kryetari i Bashkisë
- b) Jo më pak se 1/5 e anëtarëve të këshillit bashkiak
- c) Përfaqësues të grupeve të interesit, OJF
- d) Kërkesa e paraqitur nga jo më pak se një përqind e banorëve të me të drejtë vote, duhet të përmbajë nënshkrimet përkatëse të vërtetuara pranë një noteri publik.

Neni 8

Kriteret për vendosjen/riplanifikimin e veprave të artit publik

8.1Vendosja e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art” është menyra më e përshtatshme për të përkujtuar figurat sipas hirarkisë dhe rëndësisë, ngjarjet dhe fenomenet e spikatura lokale e kombetare të rëndësishme.

8.2Vendosja e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art,ka të bëjë me një ngjarje historike, nje ose disa individëve, figura te shquara, fenomeneve në nje aspekt të caktuar, si; të traditës, artit, kulturës, edukimit,sportit, historisë, shkencës, dhe atyre me karakter kombëtar, etj. Figura e spikatur apo ngjarja, duhet të ketë kaluar një periudhe të paktën 10 vjeçare. Përrjashtohen ngjarje që vinë si rezultat i forcave madhore, natyrore.

8.3Vendosja e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art mund të realizohet ne hapësira publike, por dhe private me vullnetin e tyre te lire, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë dhe miratimin e Këshillit Bashkiak.

8.4Vendosja të veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art bëhet duke respektur parimin e hapësirës së çdo vepre dhe shmangien e mbivendosjes së veprave.

8.5Vendosja e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art duhet te ruaj parimin e aksesit vizual dhe fizik të tyre nga ana e publikut në përputhje me elementet të cilat garantojnë sigurinë e veprës dhe atë qytetare.

8.6.Hapësirat publike për vendosjen e të veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, studiohen nga komisioni këshillimor në përputhje me Planin e Rregullimit të Territorit në juridiksionin e bashkisë Shkodër, duke respektuar në mënyre rigoroze vlerat dhe kontributet e figurës që përkujtohet, rëndësinë historike, kulturore dhe kombëtare.

8.7.Këto hapësira publike miratohen nga këshilli bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe duhet të jenë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, apo dokumente të tjera strategjike sa i përket vizionit dhe planeve urbanistike/infrastrukturore të Bashkisë.

8.8Gjithashtu duhet të disponojë lejet nga strukturat përkatëse, konform legjislacionit në fuqi.

8.9Propozimet përkatëse duhet të pasqyrojnë në mënyrë të qartë lidhjen historike, kulturore, natyrore, urbane e konceptuale me territorin e bashkisë Shkodër, territorin e Republikës se

Shqipërisë, historisë së saj e më gjere njëkohësisht duke mos cënuar identitetin kombëtar, lokal, kohëzisionin social dhe harmoninë ndërfaqetare.

8.10 Gjatë realizimit të veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, duhet të kryhet supervizimi artistiko-teknik i veprës nga autoriteti supervizues i cili garanton realizimin korrekt nga boceti fitues, në dimensionin real.

8.11 Veprat artit publik; bustet, shtatoret, memorialet, instalacionet artistike dhe Land-Art nuk mund të vendosen në hapësirën Publike të miratuar pa përfundimin e procedurës tekniko ligjore nga autoriteti supervizues dhe kolaudatori.

Neni 9

Procedura e propozimit dhe dokumentacioni shoqëruar

9.1 Propozimi për vendosje të veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art duhet të bëhet me anë të kërkesës zyrtare nga subjektet që kanë të drejtën e propozimit sipas nenit 7, të kësaj rregulloreje duke ju drejtuar Bashkisë Shkodër.

9.2 Kryetari i bashkisë kalon propozimin tek komisioni këshillimor pranë bashkisë Shkodër për trajtim.

9.3 Komisioni këshillimor materialin e shqyrtuar së bashku me argumentimin e pasqyruar në relacion, përcjellin vendimarrjen pranë kryetarit të bashkisë.

9.4 Kërkesa duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë lidhjen historike, kulturore e konceptuale me Bashkinë Shkodër.

9.5. Kërkesa duhet të vijë e arsyetuar dhe të përmbajë biografinë apo historikun varësisht për çka bëhet fjalë, për individ apo ngjarje, etj. *Këtu mund të përfshijmë dhe dokumentacion shoqëruar.*

Neni 10

Financimi i veprave të artit publik

10.1 Veprat e artit publik; bustet, shtatoret, memorialet, instalacionet artistike dhe Land-Art të vendosura në juridiksionin e bashkisë Shkodër, mund të financohen, apo të ndërtohet nga qeverisja qendrore ose njësi e vetëqeverisjes vendore, por edhe nga persona fizik apo juridik të cilët mund t'ia dhurojnë Bashkisë Shkodër me anë të aktit noterial, duke deklaruar burimin e financimit.

10.2 Autoritetet e vetëqeverisjes vendore të Bashkisë Shkodër, sigurojnë, ruajnë, mbrojnë, vlerësojnë dhe administrojnë veprat e artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve,

instalacioneve artistike dhe Land-Art, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi, në juridiksionin e saj, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.

Neni 11

Shqyrtimi dhe miratimi i vendosjes së veprave të artit publik

11.1 Komisioni i Këshillimit gjatë shqyrtimit të kërkesave, për vendosjen e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, në hapësirat publike të juridiksionit të Bashkisë Shkodër, respekton procedurat dhe analizon kriteret, duke marrë në konsideratë aspekte të tilla si: Vlerat e spikatura dhe kontributet e veçanta në nivel lokal apo kombëtar, të figurës që perkujtohet, apo ngjarjeve që kanë lidhje me historinë, kulturën, vlerat lokale/kombëtare, etj .

11.2 Kërkesa për vendosjen e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, pasi është përcjellë nga kryetari i bashkisë, paraprakisht shqyrtohet nga komisioni i këshillimit, brenda 3 tre muajve nga përcjellja e kërkesës.

11.3 Kryetari i Bashkisë, materialin tekniko-ligjor, për vendosjen e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, së bashku dhe me vlerësimin përkatës të komisionit këshillimor, e kalon për shqyrtim të metejshëm në zbatim të procedurave ligjore pranë Këshillit Bashkiak.

11.4 Këshilli Bashkiak është organi legjislativ i vetëqeverisjes vendore të bashkisë Shkodër që miraton ose jo propozimin përfundimtar të Kryetarit të Bashkisë për vendosjen e veprave të artit publik; busteve, shtatoreve, memorialeve, instalacioneve artistike dhe Land-Art, në hapësirat publike të juridiksionit, bashkisë Shkodër.

Neni 12

Komisioni Këshillimor, Përbërja, Funkzioni dhe Kohëzgjatja

12.1 Kryetari i Bashkisë me urdhër të posaçëm, krijon komisionin këshillimor me specialist të fushave përkatëse.

12.2 Komisioni përbëhet nga 7 anëtar dhe ka mandat 2 vjeçar.

12.3 Komisioni përbëhet nga:

- katër anëtar, përfaqësues të administratës së bashkisë, punonjës pranë strukturave përgjegjëse për kulturën, artin dhe planifikimin.
- tre anëtar, ekspertë të jashtëm me kontribute dhe kompetence profesionale në fusha të tilla si historia, tradita, kultura lokale, arkitektura, topografia, arkivat apo tema të tjera të ngjashme.
- anëtarët e Komisionit, emërohen/shkarkohen me urdhër të kryetarit të Bashkisë,

12.4Komisioni në mbledhjen e parë të tij cakton njërin prej antarëve në cilësinë e kryetarit dhe një anëtar tjetër në cilësinë e sekretarit.

12.5Kryetari i Komisionit , drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit për marrjen e vendimeve të drejta.

Neni 13 **Thirrja e mbledhjeve**

13.1Mbledhjet thirren nga Kryetari i Komisionit i cili cakton datën, orën e mbledhjes të shoqëruar me rendin e ditës.

13.2Sekretari i komisionit përgatit njoftimin së bashku me rendin e ditës dhe ia përcjellë kryetarit të komisionit për të caktuar datën, orën e mbledhjes.Njoftimi bëhet me anë te postes ne adresat e konfirmuara nga ato vete dhe në adresat emailit.Njoftimi quhet i marrë nga ana e antarëve dhe me anë të postës elektronike.

13.3Mbledhjet e komisionit zhvillohen në ambientet e bashkisë Shkodër.

13.4Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtari të Komisionit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.

13.5Rendi i dites duhet të përfshijë ato çështje që trajtohen sipas kësaj rregullore.

13.6Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e antarëve te tij (50+1).

13.7 Anëtarët që nuk jane prezent në mbledhje 3 here rresht mbasi njoftohen, shkarkohen.

13.7Kur në mbledhjen e parë, nuk janë të pranishëm shumica e anetareve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të pakten 24 ore pas mbledhjes se pare.

13.8Në mbledhje marrin pjesë pa të drejte vote edhe specialisti që mbulon kulturen në strukturen pergjegjese të kultures ,artin dhe specialist që mbulon planifikimin në bashki, të cilët janë në dispozicion të komisionit për këshillime teknike sipas nevojës.

13.9Komisioni shqyrton brenda 3(tre) muajve materialin e paraqitur sipas formës së kërkuar nga kjo rregullore dhe dispozitave ligjore në fuqi.

13.10Komisioni pas shqyrtimit të materialit, dërgon relacionin së bashku me vendimin pranë kryetarit të bashkisë Shkodër për përcjellje për shqyrtim, miratim në këshill bashkiak.

Neni 14
Marrja e vendimeve

14.1 Komisioni merr vendime për çështje të cilat janë në rendin e ditës, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

14.2 Komisioni merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

Neni 15
Proçesverbali i mbledhjes

15.1 Në çdo mbledhje mbahet një proçesverbal, ku të pasqyrohet data, orari i mbledhjes, vendi i mbledhjes, anetarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve .

15.2 Proçesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes.

Pas miratimit nga anetarët, proçesverbali nënshkruhet nga të gjithë anetarët e pranishëm.

Neni 16
Hyrja ne fuqi

16.1 Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Këshilli Bashkiak .